

FJALA E DEPUTETIT NIKO PELESHI

E ENJTE 07 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

I dashur Ambasador i Ukrainës,

Në fakt, unë nuk kisha përgatitur fjalë, nuk isha përgatitur të flisja në këtë seancë, siç e shikoni, si dhe shumë anëtarë të kabinetit, meqenëse ne donim t'ia linim me tonin e merituar zërin këtij parlamenti, për shkak se bëhet fjalë për një rezolutë parlamentare, dhe do të donim që të flisnim të gjithë në të njëjtën gjuhë për Ukrainën. Natyrisht, Shqipëria nuk është larg nga Ukraina, është më afër, e kuptuam që është më afër sesa mendonim para 24 shkurtit. Natyrisht që ne kemi sfidat tona të sigurisë kombëtare e të mbrojtjes, natyrisht që jemi në një nevojë për shkak të situatës së krijuar, në mbështetje të fjalës të zotit Xhafaj për të rishikuar dokumentet tona strategjike, dhe do t'ju them pak më vonë se çfarë jemi duke bërë për këtë, por sot është dita e Ukrainës. Çdo përpjekje për të marrë kredo politike nga ky debat, nga kjo çështje, nuk është e drejtë, nuk është etike, nuk është shqiptare, sepse ne shqiptarët kemi një gjë që nuk e ka asnjë vend në rajon: ne jemi i vetmi vend në rajon pa probleme politike në raport me orientimin tonë gjeopolitik e kjo nuk është merita e qeverisë, kjo nuk është merita e Partisë Socialiste, kjo është meritë e të gjithëve bashkë. Ne e njohim meritën tuaj, meritën e Partisë Demokratike, meritën e të gjitha partive, sado të vogla e sado të mëdha, në Shqipëri, që kanë të njëjtin orientim. Ne jemi të gjithë shqiptarë kur vjen çështja tek orientimi ynë perëndimor. Ne jemi të gjithë me Perëndimin. Nuk ka parti politike, nuk ka organizata joqeveritare në Shqipëri, që të jenë kundër orientimit tonë perëndimor.

Sot është dita të bashkohemi në këtë narrativë, jo ta dobësojmë atë, por ta themi me zë të lartë, që të dëgjohet në Bruksel, të dëgjohet aty ku duhet, në mënyrë që proceset tona integruese në këtë situatë kaq të ndryshuar gjeopolitike, të marrin shpejtësi, të tregojmë edhe një herë sesi ne jemi faktor në të gjithë rajonin, drejt Perëndimit. Sot janë tre kryeministra shqiptarë në Ballkanin Perëndimor, ndaj le ta përdorim këtë moment për mirë. Sot nuk është dita të flasim për çështjet tona shumë të mëdha, sot është dita të flasim për Ukrainën, ndaj ne nuk jemi përgatitur si kabinet, si qeveri, ndaj nuk dëgjoni ta përziejmë me probleme të tjera, ndaj nuk e përmendim Serbinë, Bosnjën, Malin e Zi, Kosovën apo vende të tjera në rajon, jo se kemi kompleks. Kryeministri shqiptar është i pari kryeministër, që në mes të Beogradit i ka kërkuar hesap Serbisë njohjen e Kosovës. Është e turpshme të tregojmë me gisht njëri-tjetrin si proserbë. Ne nuk themi që ju keni agjenda antiperëndimore. Jo. Ju jeni perëndimorë! Ju jeni shqiptarë dhe ne jemi të gjithë bashkë në orientimin tonë perëndimor. Kjo është arsyeja pse ne duhet të bashkohemi, po, të bashkohemi, të lemë mënjanë të gjitha agjendat tona politike të ditës, të mos përfitojmë mbi rritjen e çmimeve, sepse nuk është faji i Partisë Socialiste, por është faji i një situatë botërore.

Të mos merremi me çmimin e naftës, të mos marrim vota nga pakënaqësia legjitime e popullit në një situatë aspak të favorshme jo vetëm për Shqipërinë, po edhe për vende shumë më të zhvilluara se ne. Të tregojmë qytetari, të tregojmë përgjegjshmëri historike, të bashkohemi ne procesin e sapofilluar të

rishikimit të strategjisë sonë të sigurisë kombëtare. Të bëjmë një strategji kombëtare jo qeveritare. Jam shumë dakord me fjalën e zotit Xhafaj, dhe për hir të së vërtetës u frymëzova pikërisht prej asaj fjale, prej ftesës që ai bëri, ndaj unë e përsëris me zë të lartë: të tregojmë se dimë të bëjmë pakte kombëtare për çështje të mëdha. Unë drejtoj një institucion shumë të rëndësishëm, sidomos në këtë kohë. Ne mezi po presim, që me një procedurë të përshpejtuar, të miratojmë një rishikim të strategjisë tonë kombëtare, që pastaj të derivojë në një strategji të mbrojtjes, që më pas të rishikojmë edhe objektivat tona të kapaciteteve.

Natyrisht, na duhet të vëmë më shumë forca për modernizimin dhe për rritjen e buxhetit për mbrojtjen. Mbase Ballkani Perëndimor është në stacionin e radhës, të valës që krijoi agresioni rus, një valë që e kthen historinë e botës nga një botë që po zhvillohej në dukje e orientuar nga disa ideale dhe vlera globale, në një botë me shumë pole. E tha zoti Spaho dhe ka shumë të drejtë, po ndodh ajo që presidenti Putin paralajmëroi në vitin 2007. Ai kërkoi një botë me shumë pole dhe tani po kërkon ta bëjë atë realitet. Në këtë botë, që është në ndryshim, ne duhet të qëndrojmë më fort me Perëndimin, duhet t'i themi Perëndimit: jemi të gjithë bashkë, prandaj na integroni, siç e meritojmë, me procedurë të përshpejtuar dhe jo duke na bërë peng të debateve historike, gjuhësore, etnike, kulturore të papranueshme për këtë situatë. Ndjesë për tonin, por nuk e meritojmë ne; nuk e meritojnë shqiptarët të ndahen në këtë ditë. Ne jemi të gjithë bashkë me Ukrainën. E kemi ndihmuar, nuk e kemi bërë me tamtame, por po jua them përsëri këtu, sepse e kemi thënë edhe para pak ditësh, që kemi qenë nga vendet e para në Europë dhe në botë që i kemi dhënë ndihmë konkrete ushtarake Ukrainës, e kemi bërë atë me shumë sukses dhe do të vazhdojmë ta mbështesim Ukrainën me të gjitha mundësitë tona, sepse Ukraina sot nuk po lufton për Ukrainën, por po lufton për lirinë e të gjithëve. Faleminderit!